



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2020-07/IA005

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 16 qershor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatëse Nina Jorgensen

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtësve të Hysni Gucatit:

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

Mbrojtësve të Nasim Haradinajt:

Tobi Kadman

Karl Bakli

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c), dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 77(1), 169 dhe 170(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për miratimin e kërkesave të z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj për leje për apelimin e vendimit mbi mocionet e tyre lidhur me mosnxjerrjen e disa materialeve të caktuara prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) (“Vendim për Miratimin e Lejes për Apelim”)¹.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori një vendim lidhur me, ndër të tjera, mosnxjerrjen e disa materialeve të caktuara që kishte ZPS-ja.²
2. Më 3 qershor 2021, z. Haradinaj dhe z. Gucati kërkuan leje për apelimin e Vendimit të Kontestuar.³
3. Më 15 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim.⁴

II. KLASIFIKIMI

¹ F00235, Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Kërkesat B-C të Gucatit, 15 qershor 2021 (konfidencial).

² F00210, Vendim mbi Kërkesat dhe Kundërshtimet e Prokurorisë në bazë të F00172, 26 maj 2021 (konfidencial).

³ Shih F00216, Kërkesë për Leje për Apelimin e Vendimit KSC-BC-2020-07/F00210 në bazë të nenit 45(2) dhe rregullës 77(1); Kërkesë Alternative për Rishikim sipas Rregullës 79(1), 3 qershor 2021 (konfidenciale); F00219, Kërkesë për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Kërkesat dhe Kundërshtimet e Prokurorisë në bazë të F00172, 3 qershor 2021 (konfidenciale).

4. Parashtrimet e para janë të klasifikuara si konfidenciale dhe rrjedhimisht edhe ky vendim do të ketë të njëjtin klasifikim në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, deri në riklasifikimin e tij në kohën e duhur në përputhje me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

III. CAKTIMI

5. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Emilio Gati

Gjykatësin Nina Jorgensen

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi Apelet e dorëzuara në përputhje me Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Kryetare e Dhomave të Specializuara

E mërkurë, 16 qershor 2021
Në Hagë,
Holandë

⁴ Shih Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim.